ARRËRI

Vrasësi i shtatzënës vetëvritet në prezencë të Policisë

2 dhjetor 2022, 14:12

Shpërndaje në

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka bërë të ditur se vrasësi i gruas shtatzënë H.M., është vetëvrarë të premten në prezencë të Policisë së Kosovës, pasi është lokalizuar.

"Pas një pune intenzive të të gjitha njësiteve të Policisë së Kosovës është arritur që të lokalizohet vendndodhja e vrasësit Sokol Haliti. Përkundër tentativës së zyrtarëve policorë që të negociojnë dorëzimin, dorasi vret veten. Policia e Kosovës si dhe Inspektoriati Policor i Kosovës do të vazhdojnë hetimet për zbulimin e të gjitha rrethanave të vrasjes së gruas shtatzënë dhe vetëvrasjes së dorasit", ka shkruar Sveçla.

Gruaja shtatzënë 35-vjeçare është vrarë nga bashkëshorti i saj S.H., të mërkurën në mbrëmje, përpara Klinikës së Gjinekologjisë në QKUK.

Viktima ishte në javën e 41 të shtatzënisë në momentin kur është qëlluar për vdekje me armë zjarri.

Vrasja e saj ka nxitur reagime të shumta në Kosovë. Të premten në Prishtinë është mbajtur një protestë ku është kërkuar që vrasja e grave të trajtohet si urgjencë kombëtare.

Vrasja e shtatzënës është e dyta e ngjashme brenda pak ditësh në Kosovë. Më 30 nëntor në Prishtinë një grua 63-vjeçare është vrarë me sëpatë nga bashkëshorti i saj, 70-vjeçar.

VIDEO:

Pamje nga vendi ku u vetëvra Sokol Haliti, VIDEO:

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

Taboola Feed

Kostoja e transplantit të flokëve në Turqi mund t'ju befasojë

Transplantet e flokeve | Iidhje te sponsorizuara | Sponsored

Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek

megazbritje.al | Sponsored



E humb kontrollin futbollisti serb: Do ta nokautoja Xhakën apo Shaqirin

Ish-futbollisti i Serbisë, Zdravko Kuzmanoviq, ka treguar fytyrën e vërtetë. Ai ka thënë se do të nokautonte Granit Xhakën apo Xherdan Shaqirin nëse do të ishte ende pjesë e Serbisë. …

Kohanet



Staying in a Luxury Hotel in Dubai in 2023 Might Be Cheaper Than You Think!

Dubai Hotels | Search Ads | Sponsored

TË TJERA

Varroset shtatzëna që u vra para Gjinekologjisë

GLPS: Ka ngecje në sundimin e ligjit në Kosovë

Pezullohet vendimi i Qeverisë për uljen e pagave në sistemin e drejtësisë

Gucati dhe Haradinaj kërkojnë nga Apeli që të lirohen nga akuzat

Partnerët: Shkabaj

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krait njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, Kohavision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeljet e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.